



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.8, datë 5.2.2007

**PËR
KALIMIN KAPITAL NË ADMINISTRIM TË NJËSISË BASHKIAKE NR.10, TË ASETIT
TË APARATIT TË BASHKISË SË TIRANËS “QENDËR KOMUNITARE PËR TË
MOSHUARIT”, DERI NË PËRFUNDIM TË PROJEKTIT
NGA BANKA BOTËRORE**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjit Nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153, datë 3.4.1993 “Për kalimin kapital të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.626, datë 21.9.2001 “Për miratimin e listave të inventarit dhe transferimin në pronësi të Bashkive dhe Komunave të disa pronave të paluajtshme shtetërore, që do të transferohen për ngritjen e qendrave të shërbimeve sociale”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.62, datë 10.11.2006 “Për krijimin e qendrave sociale “Qendër komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë”, qendrës “Të qëndrojmë së bashku” dhe qendrës “Qendër komunitare për të moshuarit”, miratimin e strukturës organizative dhe financimin e kontributit të Bashkisë së Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të kalojë në administrim të Njesisë Bashkiake Nr.10, 485 m² të asetit të aparatit të Bashkisë së Tiranës “Qendër komunitare për të moshuarit” (pjesa veriperëndimore), deri në përfundimin e projektit nga Banka Botërore me vlerë kontabile 8.548.872 lekë (bashkëngjitur genplani përkatës).
2. Destinacioni për të cilin merret në administrim aseti, të mbetet “Qendër komunitare për të moshuarit”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Njësia Bashkiake Nr.10 për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI